

**V E N D I M**

**PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK**

Sot me date 20.03.2000 une gjyqtaria e Gjykates se rrethit Tirane, .....  
pasi studjova materialet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "MATI  
UNION" sh.p.k me ortak te vetem Z. Mustafa Martinaj.

**K o n s t a t o v a s e:**

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "MATI UNION" me ortak te vetem Z. Mustafa Martinaj, ka paraqitur kerkesen ne gjykate per tu regjistruar si person juridik qe fiton te drejten per te vepruar. Objekti i veprimtarise se saj do te jete:

- aktivitetin te sherbimeve financiare te kambizmit, te ndermjetesimit te pagesave. te transaksioneve financiare
- aktivitetin e konsulences ne fushen e biznesit dhe administrimit
- te agentit turistik e te udhetimeve
- aktivitetin e marketingut, agentit komisionar apo perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.
- dhe ne pergjithesi, te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

Kapitali i shoqerise do te jete 25.000 USD.

Selia e shoqerise do te jete ne adresen Prana Bashkise - Lac.

Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

Administrator i pare i Shoqerise do te jete Mustafa Martinaj.

Nga materialet e paraqitura rezulton se veprimtaria e shoqerise eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligja dhe si e tille duhet te pranohet.

**P E R K E T O A R S Y E**

Ne baze te nenit 5 te Ligjit Nr.7512 date 10 Gusht 1991 dhe Ligjit Nr.7638 date 19 Nentor 1992,

## VENDOSA

Te regjistroj ne Gjykate si person juridik qe fiton zotesine per te vepruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "MATI UNION" sh.p.k me ortak te vetem Z. Mustafa Martinaj, per te ushtruar veprimtarine private me objekt:

- aktivitetin e sherbimeve financiare  
te kambizmit,  
te ndermjetesimit te pagesave.  
te transaksioneve financiare
- aktivitetin e konsulences ne fushen e biznesit dhe administrimit
- te agentit turistik e te udhetimeve
- aktivitetin e marketingut, agentit komisionar apo perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.
- dhe ne pergjithesi, te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

Kapitali i shoqerise do te jete 25.000 USD.

Selia e shoqerise do te jete ne adresen pran Bashkise – Lac.

Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

Administrator i pare i shoqerise do te jete Mustafa Martinaj.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkalle te dyte.

GJYQ TAR

(.....*Agjiesi Salahu*.....)  
*Agjiesi*


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 GJYKATA E RRETHIT TIRANË  
 Seksioni Tregtar

URDHËR REGJISTRIMI

Kolona 1	Kolona 2	Kolona 3	Kolona 4	Kolona 5
Nr. rendor i Regjistrimit Tregtar:  <u>23.445</u>	Emri: "Moti Union" Sh.p.k b. Selia: <u>Jez. prandë</u> <u>Bashki</u> c. Objekti: <u>Aktivitet financiar</u> <u>me funksion e kom.</u> <u>kequmit, të cilët një</u> <u>të cilët të përgjeron</u> <u>të transaktive</u> <u>financiare sh.</u> ç. Kapitali: <u>25000 USD</u> <u>Konfirmim bankar</u> <u>Tirana Banka</u> <u>14.08.23.2000</u>	a. Ortakët: 1. <u>Mustafa Mustafaj</u> 2. _____ 3. _____ 4. _____ 5. _____ 6. _____ 7. _____ Administratori/et: 1. <u>Mustafa Mustafaj</u> 2. _____ 3. _____	Kohëzgjatja: <u>pa kufizim</u>	Shëmime mbi aktet e shoqërisë.  Data e nënshkrimit: <u>24.02.2000</u>  Data e regjistrimit: <u>20.03.2000</u>

GJYQTARE

Zina Sollaku



**Akti i themelimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar  
"MATI UNION shpk."**

Z. 1 – Mustafa Martinaj, I biri I Haxhiut, lindur ne Lac, me 10/03/1953, banues ne Lac, me zotesi zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I pasaportes n. 0135807

Deklaron te themeloje nje shoqeri me pegjegjesi te kufizuar, me emertimin social "MATI UNION" shpk, me seli prane Bashkise ne Lac, Shqiperi.

2) Objekti i shoqerise eshte:

- Aktiviteti I sherbimeve financiare
  - Te kambizimit
  - Te ndermjetesimit te pagesave
  - Te transakcioneve financiare
- Aktivitetin e konsulences ne fushen e biznesit dhe adminisytrimit
- Te agentit turistik e te udhetimeve
- Aktivitetin e marketingut, te agentit komisionar apo perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.

Dhe ne pergjithesi, te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

3) Afati i veprimtarise se shoqerise eshte I papercaktuar dhe jo me pak se 10 vjet.

4) Kapitali shoqeror eshte USD 25.000 ( njezete e pesemije ) dhe i nenshkruar ne kete menyre:

1- Z.Mustafa Martinaj kontribuon me 100%= 25.000 USD

Kapitali shoqeror eshte i perbere nga 50 kuota krejtesisht te paguara, me vlere prej 50 USD leke secila, me numra serie nga 1 deri 50.

Ne baze te kontributeve te lartpermendura Z.Mustafa Martinaj merr n. 50 kuota nga kapitali shoqeror.

5) Shoqeria do te administrohet nga administratori i vetem Z.Mustafa Martinaj.

Administratori perfaqeson shoqerine perballe te treteve dhe ngarkohet me procedurat e administrimit te zakonshem te shoqerise.

6) Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Viti i pare ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor 2000.





Ne rast se ortakët pas nënshkrimit të kapitalit fillestar, nuk i përgjigjen plotësisht apo pjesërisht ( madhësi të investimit, kohës dhe vlerës së investimit), investimeve të shoqërisë, atëherë asambleja e zakonshme e ortakëve vendos largimin e ortakut jokorrekt nga shoqëria dhe bën likuidimin me të përmes blerjes së kuotave të tij prej ortakëve të tjerë të shoqërisë.

Ky akt themelimi është hartuar në Tiranë në pesë ekzemplare.

Shoqëria krijohet dhe do të ushtrojë aktivitet në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi, L.n. 7638 del 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare", L.n.8287 dt.18.02.1998 dhe ligje të tjera që do të jenë në fuqi gjatë periudhës së aktivitetit të shoqërisë, si dhe në përputhje me statutin që konsiderohet pjesë përbërëse e këtij akti dhe që i bashkëngjitet si ANEKSI B.

Lexuar, pranuar dhe nënshkruar;

**ORTAKU**

**MUSTAFA MARTINAJ**



**Notere Gentiana SHKODRA**  
**Myslym Shyri, P.46, Sh.4, Ap.31**  
**Tel/fax + 355 42 32210**  
NR.....<sup>333</sup>.....**REP**  
NR.....<sup>82</sup>.....**KOL**


---

Sot, me date 24/02/2000 , para meje notere Gentiana SHKODRA, me seli ne qytetin e Tiranës sa me lart, u paraqit:

**Z. Mustafa Martinaj, I biri I Haxhiut, lindur ne Lac, me 10/03/1953, banues ne Lac, me zotesi zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I pasaportes n. 0135807**

qe me kerkoi vertetimin e nenshkrimtit te tij vene ne thember te aktit te themelimit te shoqerise "MATI UNION" shpk.

Deklaroj une e nenshkuara Gentiana SHKODRA, notere ne Tirane, se personi i lartpermendur ka firmosur lirisht ne pranine time ne thember te ketij akti.

  
**GENTIANA SHKODRA**  


**STATUT**  
**i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar**  
**“MATI UNION “ me seli ne Lac**  
**( ne zbatim te ligjit n. 7638 date 29.11.1992)**

**KREU I**  
**Emertimi - objekti,**  
**Selia – Afati**

**Art.1**

Eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin social “MATI UNION”shpk.

**Art.2**

Objekti i shoqerise eshte:

- Aktiviteti I sherbimeve financiare
  - Te kambizimit
  - Te ndermjetesimit te pagesave
  - Te transaksioneve financiare
- Aktivitetin e konsulences ne fushen e biznesit dhe adminisytrimit
- Te agentit turistik e te udhetimeve
- Aktivitetin e marketingut, te agentit komisionar apo perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.

Dhe ne pergjithesi, te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

**Art.3**

Selia e shoqerise eshte ne Lac, prane bashkise se qytetit. Administratori i vetem ka te drejte te hape seli sekondare, filiale, zyra perfaqesimi dhe agjensi kudo ne Shqiperi.

**Art.4**

Vendqendrimi zyrtar i ortakeve per cdo raport me shoqerine eshte adresa qe rezulton nga libri I ortakeve.

**Art.5**

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte I papercaktuar dhe jo me pak se 10 vjet.


**Kreu II**  
**Kapitali shoqeror dhe kuotat**

**Art. 6**

Kapitali shoqeror eshte fiksuar ne USD 25.000 ( njezete e pese mije ) dhe mund te rritet sipas modaliteteve ligjore.

**Art. 7**





Kapitali shoqeror eshte i ndare ne 50 kuota , ne asnje rast me te vogla se USD 50 secila

#### **Art.8**

Kuotat jane lirisht te transferueshme midis ortakeve. Duke marre ne konsiderate sa eshte parashikuar ne aktin e themelimit, transferimi i kuotave jo ortakeve, per cfaredo shkak, do t'i nenshtrohet te drejtes se parablerjes. Kjo e drejte e parablerjes i takon cdo ortaku ne perputhje me kuotat e mbajtura dhe duhet te ushtrohet brenda 30 ditesh nga marrja e ofertes se bere nga ortaku qe do te shese kuotat. Oferta behet me leter rekomande dhe duhet te njoftohet marrja e saj.

Ne rast mosushtrimi te se drejtes se parablerjes brenda tridhjete ditesh nga oferta, kuotat do t'i transferohen lirisht te treteve.

#### **Art.9**

Ne rast rritje te kapitalit shoqeror, kuotat e reja duhet te afrohen nga ortaket ne mase proporcionale me kapitalin e poseduar prej tyre.

#### **Art.10**

Financimet e bera nga ortaket ne shoqeri ne proporcion me kuotat e disponuara, dhe ne perputhje me vendimet e asamblese, jane te lira nga interesat.

### **Kreu III ORGANET DREJTUESE ASAMBLETE**

#### **Art. 11**

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme sipas ligjit.

Asambleja e zakonshme thirret te pakten nje here ne vit, per miratimin e bilancit, brenda kater muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor.

Asambleja e jashtezakonshme thirret per te vendosur per te gjitha ceshtjet ne kompetence te saj (sipas modaliteteve te ligjit) kur administratoret ose shumica e ortakeve e cmojne te nevojshme.

#### **Art.12**

Asamblete e zakonshme dhe te jashtezakonshme thirren nga administratoret dhe jashte selise se shoqerise me leter rekomande te nisur ortakeve, ne vendbanimin qe rezulton nga libri i ortakeve, te pakten 10 dite para dites se caktuar per mbledhje.

Ne leter duhet te tregohet vendi, dita, ora e mbledhjes dhe rendi i dites per diskutim. Me te njejtin mjet do te tregohen dita, vendi, ora per mbledhjen e dyte, ne rast se e para nuk zhvillohet.

Secili ortak mund te perfaqesohet ne asamble me nje prokure me shkrim. Rregullshmeria e prokures duhet te pranohet nga presidenti i asamblese.





**Art.13**

Mund te marrin pjese ne asamble te gjithë ortaket qe rezultojne te rregjistruar ne librin e ortakeve te pakten 5 dite para dites se caktuar per mbledhjen e asamblese.

**Art.14**

Asambleja drejtohet nga presidenti qe zgjidhet mes ortakeve.

Presidenti emerohet nga te pranishmit nje sekretar, por gjithsesi proces – verbali duhet te redaktohet nga noteri sipas ligjit.

**Art.15**

Vendimet merren me votim te hapur ( me dore te ngritur ), me perjashtim te rastit kur administratori nuk e gjykon oportun apelin emeror si ne rastin e votimit te bere per ceshtje sekrete.

Proces – verbalet e asamblese se zakonshme mbahen ne liber dhe firmosen nga presidenti dhe sekretari ose noteri. Ne proces – verbale duhet te perfshihen, me kerkesen e ortakeve deklarimet e tyre.

I takon presidentit te konstatoje rregullshmerine e pjesemarrjes ne asamble dhe te vlefshmerise se saj.

**Art.16**

Asambleja e zakonshme si ne mbledhjen e pare ashtu dhe ne ate te dyten merr vendime me shumicen e ortakeve te pranishem vete apo te perfaqesuar me prokure dhe qe posedojne me shume se gjysmen e kapitalit shoqeror.

Asambleja e zakonshme aprovon bilancin, vendos per shperblimin e administratoreve, kerkon derdhjet e kapitalit te nenshkruar por te paderdhur, vendos per ceshtje te tjera lidhur me drejtimin e shoqerise qe jane brenda kompetencave te njohura asaj nga akti i themelimit, ushtron kontroll mbi aktivitetin e administratoreve. Asambleja e zakonshme emerohet dhe revokon administratoret me nje maxhoranse te cilesuar prej 75% te kapitalit social.

**Art.17**

Mbledhja e asamblese se jashtezakonshme, qofte e para apo e dyta, eshte e vlefshme kur marrin pjese shumica e ortakeve qe perfaqesojne te pakten ¼ e kapitalit social.

Per vlefshmerine e vendimeve eshte e nevojshme nje vote 75% e kapitalit shoqeror, duke respektuar gjithmone kerkesat e ligjit.

Asambleja e jashtezakonshme vendos per ndryshimet e statutit, per rritjen e kapitalit social, per emetimin e obligacioneve, dhe per emerimin e likuidatoreve, tekompentencave te tyre, te akteve te nevojshem per likuidim, duke i dhene atyre te drejten te shesin dhe ne bllok te te mirave shoqerore dhe te bejne transaksione dhe marreveshje.

**Kreu IV**

**Administrimi**

**Art.18**

Shoqeria administrohet nga administratori i vetem, i cili qendron ne detyre deri ne revokimin e tij nga asambleja ose kur jep doreheqjen dhe eshte i rizgjedhshem.



Me kete akt, administratori I vetem I shoqerise emerohet Z. Mustafa Martinaj, ortaku I vetem I shoqerise.

**Art.19**

Administratori i vetem ka te drejta te cdo lloji, kufizuara dhe te lidhura me drejtimin e zakonshem te shoqerise, dhe qe synojne permbushjen dhe realizimin e objektit shoqeror te shoqerise, te drejta keto qe nga ligji nuk jane njohur taksativisht per asamblene e ortakeve.

**Art.20**

Administratori ka te drejten e firmes perfaqesuese te shoqerise perballe te treteve dhe ne gjykim, me te drejten qe te kryeje veprime, procedura ne shkalle te ndryshme gjyqesore dhe administrative, si dhe te mirekuptohet, keshillohet dhe te arrije ne marreveshje.

**Art.21**

Administratori i vetem mund te emerojn drejtore dhe perfaqesues dhe midis personave jashte shoqerise duke vendosur shperblimet perkatese.

**Art.23**

Administratori I vetem mund te delegoje pjese te te drejtave dhe kompetencave te tij, perfshire dhe te drejten e perdorimit te firmes se shoqerise nje ose disa perfaqesuesve te vecante, duke i caktuar ketyre kompetencat, funksionet dhe shperblimet.

**Art.24**

Shperblimi per administratoret, pertej shpenzimeve te nevojshme per mbajtjen e zyres se tyre, vendoset nga asambleja e ortakeve.

**Art.25**

Administratori qe nuk ka marre pelqimin paraprak te asamblese se ortakeve, nuk mund te jene ortake ne shoqeri konkurente dhe nuk mund te ushtrojne per llogari te vet aktivite konkurrese me objektin shoqeror te shoqerise.

**Kreu V**

**Kontrolli i ortakeve**

**Art.26**

Secili ortak ka te drejte te vihet ne dijeni nga administratori per ecurine e puneve te shoqerise dhe te konsultohet me librat shoqerore.

Ortaket qe perfaqesojne nje te terten e kapitalit kane vec te tjerash te drejten te bejne cdo vit, me shpenzimet e veta, kontrollin e drejtimit.

**Kreu VI**

**Bilanci dhe te ardhurat**

**Art.27**

Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti dhe viti i pare mbyllet me 31 dhjetor 1999.





Asambleja per aprovimin e bilancit thirret brenda kater muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor.

#### **Art. 28**

Te ardhurat neto, pasi eshte zbritur shuma prej 5% e destinuar per fondin e zakonshem rezerve, derisa kjo kuote te mos kete arritur 1/5 e kapitalit te shoqerise, do te ndahen midis ortakeve ne proporcion me kuotat e poseduara, me perjashtim te rastit kur eshte vendosur ndryshe nga asambleja.

#### **Art.29**

Pagesa e dividendeve do te behet, ne afatet e percaktuara nga asambleja, prane selise se shoqerise.  
Dividentet e pa shperndare brenda 5 vjetesh parashkruhen ne favor te shoqerise.

### **Kreu VIII Shperberja dhe likuidimi**

#### **Art.30**

Duke pasur te drejte te vendose, ne cdo kohe dhe per cdo shkak shperberjen e shoqerise, asambleja percakton modalitetet e likuidimit dhe emerone nje ose disa likuidatore, duke marre ne konsiderate normat detyruese te ligjit.

### **Kreu IX Kompetenca gjyqesore**

#### **Art.31**

Organi gjyqesor kompetent per shoqerine eshte Gjykata e Rrethit Tirane dhe nese eshte e mundur mund te behet ankim ne arbitrazh.

### **Kreu X Dispozita te pergithshme**

#### **Art.32**

Cfare nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut, rregullohet ne baze te dispozitave te ligjit shqiptar ne fushen e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar.

#### **Art.33**

Ky statut eshte hartuar ne Tirane ne pese ekzemplare, me te njejten vlefshmeri.

Ortaku I vetem deklarone te kete rilexuar kete akt qe e pranon teresisht me nenshkrimet e tij:

**ORTAKU:**

**MUSTAFA MARTINAJ**



**Notere Gentiana SHKODRA**  
**Myslym Shyri, P.46, Sh.4, Ap.31**  
**Tel/fax + 355 42 32210**  
**NR.....334.....REP**  
**NR.....6./.....KOL**


---

Sot, me date 24/02/2000 , para meje notere Gentiana SHKODRA, me seli ne qytetin e Tiranës sa me lart, u paraqit:

**Z. Mustafa Martinaj, I biri I Haxhiut, lindur ne Lac, me 10/03/1953, banues ne Lac, me zotesi zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I pasaportes n. 0135807**

qe me kerkoj vertetimin e nenshkrimt te tij vene ne thember te statutit te shoqerise "MATI UNION" shpk.

Deklaroj une e nenshkuara Gentiana SHKODRA, notere ne Tirane, se personi i lartpermendur ka firmosur lirisht ne pranine time ne thember te ketij akti.

  
**GENTIANA SHKODRA**  




**BANKA e TIRANES**  
**TIRANA BANK**

KODI FISKAL / FISKAL CODE : 3607408 NIPT / TAXE CODE : J 61924008 V

**Per : Z. Mustafa MARTINAJ**

**Tirane, me 08.03.2000**

## **KONFIRMIM BANKAR**

Sipas kerkeses Tuaj konfirmojme se Z. Mustafa MARTINAJ ka prane Bankes se Tiranes Sh. A llogari bankare me nr. 0100-104758-001 dhe ne kete llogari ka bllokuar shumen e USD 25,000 (Njzetepesemije Dollare) si Kapital Fillestar per firmen "MATI UNION" SH.P.K.

**BANKA E TIRANES SH. A**

**TIRANA BANK S.A.**  
**TIRANA BRANCH**

**EDUARD SHALSI**



**Kerkues:** Mustafa Martinaj, I biri I Haxhiut, lindur ne Gurez, me 10/03/1953, banues ne Lac, Lagjia 4, me zotesi te plate juridike per te vepruar, mbjajtes I pasaportes n. 0135807

**Objekti:** Rregjistrimi ne Gjykatën e Rrethit Tirane te Shoqerise "MATI UNION" shpk.

**Baza ligjore:** Ligji n.7638 date 19.11.1992 dhe ligji 7667 date 28.01.1993.

23.445

**PER KOMPETENCE  
GJYKATES SE RRETHIT TIRANE**

Me date 24/02/2000 ne Tirane eshte themeluar shoqeria "UNIONI LAC", shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me ortak te vetem Z. Mustafa Martinaj.

- Objekti i shoqerise eshte:
  - aktivitetin e sherbimeve financiare te kambizmit,
  - te ndermjetesimit te pagesave.
  - te transaksioneve financiare
  - aktivitetin e konsulences ne fushen e biznesit dhe administrimit te agjentit turistik e te udhetimeve
  - aktivitetin e marketingut, agjentit komisionar apo perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.
  - dhe ne pergjithesi, te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte ose indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me to, qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar.

*Te regjistruhet bashkë  
Tirane më 20.03.2000  
Gjykatari Z. Sullaku  
Hollakaj*

- Selia e shoqerise eshte ne Lac prane Bashkise.
- Afati i veprimtarise se shoqerise eshte I papercaktuar.
- Kapitali shoqeror eshte fiksuar ne leke 25.000 (njezete e pesemije) USD, i shlyer teresisht nga ortaku I vetem.
- Administratori I pare I shoqerise eshte Z.Mustafa Martinaj.

*Shënim: Kompetencën bashkë  
për shërbime ligjore  
04.09.03 2000. Sullaku bashkë  
nr. Reg. 0100-10458-001.  
Hollakaj.*

Meqe per te fituar personalitetin e saj juridik shoqeria "MATI UNION" shpk, duhet te regjistruhet ne Gjykatën e Rrethit Tirane, i kerkojme kesaj gjykate qe te pranoje kete kerkese dhe te vendose regjistrimin e Shoqerise "MATI UNION shpk".

**ADMINISTRATORI**

**MUSTAFA MARTINAJ**

*Mustafa Martinaj*  
*Mustafa*

